



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 31.1.2023

Nr: 2

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E DISA KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

(ndryshuar me vendimin nr. 9 datë 1.3.2023)

Në mbështetje të nenit 20 pika 1, shkronja "g", nenit 97, pikat 2 e 3/1 dhe nenit 98 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen brenda afatit ligjor, mund të ndryshohen përmasat e fletëve të votimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Data: 31.1.2023 Nr: 2
Ora: 13:30



"Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**



(ndryshuar kodi i ngjyrës së fletës së votimit me vendimin nr.9 datë 1.3.2023)

Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

Lloji i letrës:

Letër me thurje (watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjinë, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës (CorelDRAW):

PANTONE 7401 U

Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës
"/" ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit

(ndryshuar kodi i ngjyrës së fletës së votimit me vendimin nr.9 datë 1.3.2023)

Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

Lloji i letrës:

Letër methurje (Äatermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Peizazh (Landscape)

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës (CorelDRAW):

PANTONE 179 – 2 U

Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

• Numri serial

7 shifra

• Qarku

2 shifra

• Bashkia

2 shifra

• Zona e administrimit zgjedhor

2 shifra

• Numri i qendrës së votimit

6 shifra dhe elementin ndarës

“/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit